



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

I KËSHILLIT PËR LEGJISLACIONIN

LIDHUR ME

**KËRKESËN E 36 DEPUTETËVE TË GRUPIT PARLAMENTAR TË PARTISË
DEMOKRATIKE PËR SHKARKIMIN E KRYETARIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË Z. NIKO PELESHI**

PËRMBAJTJA

I.	HYRJE	3
II.	RRETHANAT E CËSHTJES	5
III.	E DREJTA E APLIKUESHME	10
IV.	ANALIZA LIGJORE	16
V.	KONKLUZIONE	19

I. HYRJE

1. Me shkresën nr. 2529 prot., datë 19.09.2025, 36 deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kanë paraqitur pranë Këshillit për Legjislacionin kërkesën me objekt: *“Kërkesë për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Z. Niko Peleshi”*. Në përmbajtje të kësaj kërkesë, kërkesit kanë argumentuar gjërësisht të gjitha shkeljet e konsumuara nga Kryetari i Kuvendit gjatë seancave plenare të datave 16 dhe 18 Shtator 2025, të cilat përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit të mjaftueshme për fillimin e procedurës së shkarkimit të Kryetarit të Kuvendit, në kuptim të nenit 75, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 114, pika 4, të Rregullores së Kuvendit.

2. Në memon me lëndë *“Për thirrjen e Këshillit për Legjislacionit”*, të Shërbimit Juridik të Kuvendit të Shqipërisë, thuhet: *“Në zbatim të pikave 1 dhe 4 të nenit 114 të Rregullores, për këtë kërkesë duhet të vihet në dijeni Kuvendi, si dhe kërkesa t’i dërgohet kryesuesit të Këshillit për Legjislacionin.”*. Më tej thuhet: *“Nisur nga ky përcaktim, llogaritur sipas renditjes alfabetike të mbiemrit, si dhe duke ruajtur parimin e kryesimit një herë nga shumica dhe një herë nga pakica parlamentare, rezulton se kryesimi i Këshillit për Legjislacionin duhet t’i kalojë deputetes Aulona Bylykbashi.”*. Në konkluzion, Shërbimi Juridik shprehet se: *“Aspekti Formal: Kërkesa plotëson kërkesën e pikës 1 të nenit 114 të Rregullores së Kuvendit. Kërkesa është firmosur nga 36 deputetë.”*.

3. Pas depozitimit të kësaj kërkesë, duke u bazuar në memon e përgatitur nga Shërbimi Juridik, me urdhërin nr. 16, datë 02.10.2025, kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Niko Peleshi ka urdhëruar: *“I. Thirrjen e mbledhjes së Këshillit për Legjislacionin ditën e hënë, datë 06.10.2025, ora 11:00. II. Rendi i ditës është si më poshtë: - Konstituimi i Këshillit për Legjislacionit. – Shqyrtimi i kërkesës së një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike “Për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Z. Niko Peleshi. III. Bazuar në nenin 14, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, Këshilli për Legjislacionin do të kryesohet nga zonja Aulona Bylykbashi.”*.

4. Këshilli për Legjislacionin ka zhvilluar dy mbledhje për shqyrtimin e kërkesës së 36 deputetëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, Z. Niko Peleshi, përkatësisht në datat 06.10.2025 dhe 14.10.2025. Gjatë këtyre dy mbledhjeve, është bërë prezantimi i kërkesës nga deputeti Ivi Kaso, janë caktuar relatorët nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike dhe Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, janë paraqitur qëndrimet e relatorëve lidhur me kërkesën, si dhe kanë shprehur mendimet e tyre edhe deputetët e tjerë anëtarë të Këshillit për Legjislacionin.

5. Në mbledhjen e tretë të zhvilluar në datën 28.10.2025, ora 13:00, me rend dite: “1. *Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 15.10.2025*; 2. *Miratimi i raportit për Seancën Plenare.*”, relatorët, përkatësisht deputeti (PD) Ivi Kaso dhe deputeti (PS) Damian Gjiknuri kanë paraqitur raportet përkatëse. Deputeti Kaso, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike ka mbajtur qëndrimin se kërkesa e paraqitur përmbush kushtet formale, procedurale dhe substanciale për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, ndërsa deputeti Gjiknuri ka mbajtur qëndrimin se kërkesa, megjithëse përmbush kriteret formalo-procedurale, nuk përmbush kriteret substanciale për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë. Për shkak të barazisë shumicë-pakicë, Këshilli do t’i paraqesë Seancës Plenare dy raporte lidhur me kërkesën për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë Z. Niko Peleshi.

II. RRETHANAT E CËSHTJES

A. LIDHUR ME SEANCËN PLENARE TË DATËS 16.09.2025

6. Kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, me urdhërin nr. 1, datë 15.09.2025, ka njoftuar mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare, datë 16.09.2025, ora 10:00, me rend dite: “1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të datës 12.09.2025. 2. Njoftime. 3. Projektvendimi “Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të Kuvendit”. 4. Projektvendimi “Për zgjedhjen e sekretariateve të Byrosë të Kuvendit”. 5. Projektvendimi “Për përbërjen e Byrosë së Kuvendit”.”. Po ashtu, në të njëjtën ditë, në të njëjtën orë, kryetari i Kuvendit, Niko Peleshi, me urdhërin nr. 2, datë 15.09.2025, ka njoftuar mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare, datë 16.09.2025, ora 17:00, me rend dite: “1. Projektvendimi “Për zgjedhjen e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”.”.

7. Në datën 16.09.2025, ora 10:00, është mbledhur seanca plenare e Kuvendit, gjatë të cilës kryetari i Kuvendit, ndër të tjera, ka relatuar se është paraqitur një kërkesë nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla për ndryshimin e rendit të ditës, duke përfshirë edhe shqyrtimin e projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”. Po ashtu, kryetari i Kuvendit ka relatuar edhe një kërkesë të paraqitur nga 30 (tridhjetë) deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar të projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004 “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë”, të ndryshuar”.

8. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, lidhur me këto dy kërkesa, i ka parashtruar paraprakisht Kryetarit të Kuvendit se thirrja e mbledhjes së Kuvendit dhe njoftimi i saj pa kaluar as 24 orë nga zhvillimi i seancës plenare është në kundërshtim me nenin 78, pika 2, të Kushtetutës, ashtu si edhe nenin 27/1, pika 3, të Rregullores së Kuvendit. Kjo e fundit parashikon se thirrja e mbledhjes së Kuvendit dhe njoftimi i rendit të ditës bëhet publik si rregull 7 ditë përpara, por jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për seancën plenare. Në këtë kuptim, duke qenë një mbledhje e thirrur në kundërshtim me Rregulloren, ajo nuk mund të prodhojë asnjë pasojë. Po ashtu, lidhur me shqyrtimin e projektvendimit me procedurë të

përsheptuar, opozita ka sjellë në vëmendje se sipas nenit 83, pika 2, të Kushtetutës, ashtu edhe nenit 28, pika 4, të Rregullores, shqyrtimi nuk mund të fillojë pa kaluar një javë nga data e paraqitjes së kërkesës në seancë plenare. Megjithatë, kryetari i Kuvendit ka vijuar me hedhjen e dy kërkesave në votim dhe me shumicë votash është vendosur miratimi i tyre.

9. Pas miratimit të dy kërkesave, kryetari i Kuvendit ka njoftuar thirrjen e mbledhjes së Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin për shqyrtimin e projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, dhe mbledhjen e Kuvendit sërish në ora 12:30 për vijimin e shqyrtimit dhe miratimit të projektvendimit. Gjatë mbledhjes së Këshillit për Rregulloren, 5 (pesë) anëtarët, deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kanë parashtruar se këto ndryshime, përveçse bëhen në mënyrë të njëanshme, duke shkelur për herë të dytë traditën e miratimit me konsensus ndërpartiak, shkelin në mënyrë flagrante dispozitat e Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit, të cilat rregullojnë mënyrën e thirrjes dhe njoftimit të mbledhjes së Kuvendit, ashtu edhe shqyrtimin e projektvendimeve me procedurë të përsheptuar, jo më herët se 1 javë nga depozitimi (shih nenet 78, pika 2; 83, pika 2, të Kushtetutës; nenet 27/1, pika 3; 28, pika 4; 117 të Rregullores së Kuvendit).

10. Pas rifillimit të seancës plenare, deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kanë parashtruar sërish qëndrimin e tyre sa i përket shkeljeve të Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit. Kryetari i Kuvendit ka njoftuar se për projektvendimin për disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit nuk do të ketë diskutime, çka sërish është kontestuar nga deputetët e opozitës si shkelje e nenit 75, pika 2, e Kushtetutës, e lexuar së bashku me nenet 46, pika 1, 48, pika 1, dhe 117 të Rregullores së Kuvendit, pasi i mohohet e drejta e fjalës deputetëve që dëshirojnë të diskutojnë rreth ndryshimeve të propozuara. Edhe ky qëndrim është injoruar nga kryetari i Kuvendit, i cili ka vijuar me votimin dhe miratimin e projektvendimit për disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit.

B. LIDHUR ME SEANCËN PLENARE TË DATËS 18.09.2025

11. Në mbështetje të nenit 97 të Kushtetutës dhe nenit 110 të Rregullores së Kuvendit, me urdhër të Kryetarit të Kuvendit, më datë 18.09.2025, ora 10:00, ishte thirrur seanca plenare, me rend dite projektvendimin “Për miratimin e programit politik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave”. Në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, deputetët e opozitës ishin prezent në sallë, për të ushtruar detyrën e tyre kushtetuese dhe për të diskutuar mbi programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave.

12. Sipas nenit 110 të Rregullores së Kuvendit, programi politik i Këshillit të Ministrave dhe përbërja e tij paraqiten në Kuvend nga Kryeministri. Kryetari i Kuvendit i dha fjalën Kryeministrit, i cili pas disa minutave diskutim, mori rolin e Kryetarit të Kuvendit, ndërpreu fjalën e tij dhe ia kaloi fjalën “*Ministres virtuale Diella*”, në kundërshtim të hapur me Kushtetutën dhe Rregulloren.

13. Ky veprim prej karagjozi dhe që çënoi rëndësinë kushtetuese të seancës plenare të datës 18.09.2025 u kundërshtua nga deputetët e opozitës, përmes një veprimi që nuk shkel etikën parlamentare dhe që është formë reagimi që përdoret në të gjitha Parlamentet e vendeve demokratike (*rasti më i fundit në Parlamentin Europian, ku eurodeputetët pas refuzimit të kërkesës për një minutë heshtje përplasën duart mbi tavolinat e tyre të punës si formë demokratike reagimi*). Fakti që Kryeministrin e kanë lëshuar nervat, është i lodhur dhe ndjehet i padenjë për të përballuar debatin parlamentar, nuk mund të nënkuptojë kurrë që ai mund t’i caktojë linjën e sjelljes deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, apo mund të vijë në seancë plenare dhe të sillet siç dëshiron në kundërshtim me Kushtetutën.

14. Salla e seancës plenare nuk mund të shndërrohet nga një Kryeministër karagjoz në një “*teatër kukullash*” dhe reagimi i opozitës ishte për mbrojtjen e Kushtetutës dhe Rregullores së Kuvendit. Kërcënimi i Kryeministrit që në nisje të fjalës së tij se deputetët e opozitës duhet të bëjnë apo sillen ashtu siç ai dëshiron, ose ndryshe Kryeministri nuk do të lejojë debatin parlamentar, është i papranueshëm dhe çënon rëndë rendin kushtetutes të një Republike Parlamentare.

15. Menjëherë pasi diskutimi i Kryeministrit ishte ndërprerë, jo nga ndërhyrjet e opozitës, por nga një video tallëse e një mesazhi virtual, Kryetari i Kuvendit, edhe pse fjala i ishte kaluar më parë Kryeministrit që duhet të vijonte me paraqitjen e programit politik, i kaloi fjalën Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste Taulant Balla, i cili pasi kërcënoi deputetët e opozitës me heqjen e të drejtës për të diskutuar, në përputhje me nenin 49, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, kërkoi 5 minuta ndërprerje të seancës. Kërkesa ishte për çështje të procedurës, në zbatim të nenit 49, pika 1, ku thuhet se: *“Për çështje të procedurës fjala jepet menjëherë. Janë çështje të procedurës, kërkesat për ndërprerjen ose shtyrjen e seancës plenare ose të diskutimeve...”*.

16. Pas fjalës për procedurë të Kryetarit të Grupit Parlamentar të PS, sipas pikës 3 të nenit 49, ku thuhet shprehimisht: *“3. Në këto raste, përveç propozuesit që diskuton jo më shumë se 3 minuta, kanë të drejtë të diskutojnë një folës pro dhe një folës kundër jo më shumë se 2 minuta secili dhe merret vendim me votim të hapur nga Kuvendi me ngritjen e dorës.”*, Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike Gazment Bardhi kërkoi të diskutonte si folës kundër 2 minuta lidhur me propozimin e bërë. Në kundërshtim me pikën 3, të nenit 49 të Rregullores së Kuvendit, Kryetari i Kuvendit nuk ia dha fjalën dhe ndërpreu seancën pa respektuar kërkesat e kësaj dispozite, dhe në mbyllje të saj u shpreh publikisht se do e jepte fjalën për procedurë menjëherë me rinisjen e seancës. Kërkesa për procedurë ishte regjistruar në sistemin elektronik të Kuvendit të Shqipërisë.

17. Në rinisjen e seancës, me një skenar asgjësues për Kuvendin dhe të parapërgatitur për të mos lejuar debat parlamentar, në kundërshtim me pikat 1 dhe 3 të nenit 49 të Rregullores, në vend që t'i jepte fjalën menjëherë Kryetarit të Grupit Parlamentar të PD, ashtu siç Rregullorja e detyron, Kryetari i Kuvendit ia kaloi përsëri fjalën Kryeministrit Edi Rama. Për të kundërshtuar këtë mohim të të drejtës së fjalës sipas Rregullores të deputetëve të opozitës, ende pa e marrë fjalën Kryeministri, një pjesë e tyre u ngritën në këmbë, për të kërkuar respektimin e Rregullores dhe të drejtën e fjalës për procedurë, që sipas nenit 49, pika 1 e Rregullores jepet menjëherë.

18. Në vend që t'i jepte opozitës të drejtën e fjalës për procedurë, Kryetari i Kuvendit ia rikaloj fjalën për procedurë Kryetarit të Grupit Parlamentar të PS Taulant Balla, një veprim që bie ndesh me nenin 49 të Rregullores, sepse i njëjti person nuk mund të marrë dy herë rresht fjalën për procedurë. Në shkelje flagrante të nenit 110 të Rregullores së Kuvendit, Kryetari i Grupit Parlamentar të PS, propozoi që Kryeministri të mos bënte paraqitjen në Kuvend të programit politik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave, deputetëve t'u hiqej e drejta e fjalës, e drejta për të bërë pyetje dhe të mos zhvillohej debat për programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave, duke urdhëruar kalimin direkt në votim.

19. Kryetari i Kuvendit, në kundërshtim me nenin 97 të Kushtetutës dhe pikat 3 dhe 4, të nenit 110 të Rregullores së Kuvendit, ku specifikohet se: *"3. Pas paraqitjes së programit politik, çdo deputet dhe grup parlamentar ka të drejtë të paraqesë pyetje për Kryeministrin. 4. Pas përgjigjeve të pyetjeve, Kryetari i Kuvendit deklaron hapjen e debatit për programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave. Koha e debatit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve, në përputhje me nenin 48 të kësaj Rregulloreje. Në përfundim të debatit, pas fjalës së kryetarëve të grupeve parlamentare, ka të drejtë të flasë Kryeministri jo më shumë se 10 minuta. Votimi nga Kuvendi i përbërjes dhe i programit politik të Këshillit të Ministrave bëhet sipas nenit 58 të kësaj Rregulloreje"*, hapi procesin e votimit dhe hodhi në votim projektvendimin "Për miratimin e programit politik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave".

III. E DREJTA E APLIKUESHME

20. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

- (i) **Neni 75** parashikon: “1. Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet. 2. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve.”.
- (ii) **Neni 76** parashikon: “1. Kryetari kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, si dhe përfaqëson Kuvendin në marrëdhëniet me të tjerët.”.
- (iii) **Neni 78** parashikon: “1. Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumës së gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përvec rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar. 2. Mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.”.
- (iv) **Neni 83** parashikon: “1. Projektligji votohet tri herë: në parim, nën për nën dhe në tërësi. 2. Kuvendi, me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një së pestës së të gjithë deputetëve, mund të shqyrtojë e miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit.”.
- (v) **Neni 97** parashikon: “Kryeministri i emëruar sipas nenit 96, nenit 104 ose 105, i paraqet për miratim Kuvendit, brenda 10 ditëve, programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij.”.

21. Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë:

- (i) **Neni 7** parashikon: “1. Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij. Ai kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, si dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme të Kuvendit dhe strukturave të tij. 2. Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, Kryetari u jep fjalën deputetëve dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, drejton dhe moderon në mënyrë të paanshme debatet, siguron rendin në seancë plenare, cakton rradhën e votimeve dhe njofton rezultatin e tyre.”.

- (ii) **Neni 14** parashikon: “1. Këshilli për Legjislacionin është organ këshillimor, që vlerëson ose jep mendim për çështje kushtetuese ose ligjore që ngrihen në lidhje me tekstin e projektligjit dhe për çështje të harmonizimit të projektligjit me aktet e tjera ligjore në fuqi ose me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe aktet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. 2. Këshilli për Legjislacionin përbëhet nga 10 deputetë, të emëruar nga Kryetari i Kuvendit, pasi ka marrë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare. Këshilli siguron përfaqëson të barabartë mes shumicës dhe opozitës parlamentare. Anëtarët e Këshillit janë me profesion jurist ose të kenë përvojë legjislative. 3. Këshilli për Legjislacionin kryesohet me rotacion çdo 5 muaj nga secili anëtar, duke filluar sipas renditjes alfabetike të mbiemrit duke ruajtur parimin e kryesimit një herë nga shumica dhe një herë nga pakica parlamentare. 4. Komisioni përgjegjës, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij, ose Kryetari i Kuvendit mund të kërkojë mendimin e Këshillit për Legjislacionin. 5. Këshilli shpreh mendimin bazuar në kërkesën e Kryetarit të Kuvendit ose të komisionit përgjegjës. 6. Kryetari i Kuvendit, bazuar në kërkesën e paraqitur, përcakton rendin e ditës. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm jo më pak se 5 anëtarë. Diskutimi i çështjeve në Këshill bëhet, për aq sa është e mundur, në mënyrën e parashikuar për komisionet e përhershme. 7. Shqyrtimi i çështjes në Këshill dhe përcjellja e raportit komisionit përgjegjës bëhen brenda një kohe të arsyeshme, të harmonizuar me kalendarin e punimeve të komisionit përgjegjës. Në mbledhjen e Këshillit mund të marrin pjesë relatori i çështjes në komisionin përgjegjës dhe propozuesi i projektligjit. Nëse komisioni përgjegjës nuk merr parasysh mendimin e Këshillit, në raportin për seancën plenare paraqiten edhe argumentet e mospranimit. Raporti i Këshillit i bashkëlidhet raportit të komisionit. 8. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli i paraqet Kryetarit të Kuvendit dhe/ose komisionit përgjegjës një raport ku pasqyrohen të gjitha opinionet për çështjen. Kryetari i Kuvendit mund të autorizojë leximin e raportit në seancë plenare nga relatori ose nga relatorët kur ka më shumë se një mendim.”.
- (iii) **Neni 27/1** parashikon: “1. Rendi i ditës i seancë plenare përmban çështjet që janë parashikuar në kalendarin 3-javor të punimeve të Kuvendit dhe që kanë

përfunduar shqyrtimin në komisionet parlamentare. 2. Për çështje të tjera, të parashikuara në këtë Rregullore, por që nuk janë pjesë e kalendarit, Kryetari i Kuvendit dhe/ose Konferenca e Kryetarëve miratojnë një rend ditë të vecantë. 3. Rendi i ditës miratohet me urdhër të Kryetarit të Kuvendit dhe bëhet publik si rregull 7 ditë përpara, por jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për seancën plenare.”.

- (iv) **Neni 28** parashikon: “1. Me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të një të pestës së të gjithë numrit të deputetëve, Kuvendi mund të shqyrtojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar. 2. Procedura e përshpejtuar nuk lejohet për shqyrtimin e projektligjeve të parashikuara në nenin 81, pika 2, të Kushtetutës, me përjashtim të shkronjës “dh”. Projektligji që synon përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian nuk shqyrtohet me procedurë të përshpejtuar. 3. Kërkesa për procedurë të përshpejtuar të shqyrtimit të projektligjit paraqitet me shkrim te Kryetari i Kuvendit, i cili ia njofton Kuvendit në seancën plenare më të parë. Pas njoftimit të Kryetarit dëgjohet një folës pro dhe një folës kundër për jo më shumë se 10 minuta. Kryetari i Kuvendit i paraqet Kuvendit për votim projektvendimin përkatës në të cilin përcaktohet data e shqyrtimit të projektligjit në komisionin përgjegjës, afati brenda të cilit mund të propozohet amendamente dhe data e shqyrtimit në seancë plenare. Konferenca e Kryetarëve mund të përcaktojë kohën e debatit në seancë plenare, duke respektuar rregullin e parashikuar në nenin 48, pika 3, të kësaj Rregulloreje. 4. Afati brenda të cilit duhet të shqyrtohet çështja në komision dhe në seancë plenare nuk mund të jetë më pak se një javë nga data e paraqitjes së kërkesës nga Kryetari i Kuvendit në seancë plenare. 5. Kuvendi nuk mund të shqyrtojë më shumë se tri projektligje me procedurë të përshpejtuar në programin 9-javor të punës së Kuvendit dhe një projektligj në kalendrin 3-javor të punimeve të tij.”.
- (v) **Neni 46** parashikon: “1. Cdo deputet që dëshiron të diskutojë për një çështje të përfshirë ose të papërfshirë në rendin e ditës duhet të regjistrohet në sekretari para fillimit të seancës plenare. Lista e diskutuesve të regjistruar u bëhet e njohur deputetëve në fillim të seancës plenare. 2. Diskutimet fillojnë pasi drejtuesi i seancës njofton hapjen e tyre. Asnjë deputet nuk mund të diskutojë pa iu dhënë

fjala nga drejtuesi i seancës plenare. 3. Fjala kërkohet me ngritjen e dorës ose nëpërmjet sistemit elektronik, në përputhje me pikën 1 të këtij neni. 4. Lejohet ndërrimi i rradhës së diskutimeve ndërmjet deputetëve në marrëveshje mes tyre. 5. Deputeti, i cili kur i jepet fjala nga drejtuesi i seancës, nuk është në sallë, konsiderohet se ka hequr dorë nga diskutimi. 6. Drejtuesi i seancës u jep fjalën diskutuesve sipas regjistrimit paraprak, duke harmonizuar pjesëmarrjen për çdo grup parlamentar. Kur lista e diskutuesve ka përfunduar ose nuk e kërkon më fjalën ndonjë deputet tjetër, Kryetari u jep fjalën kryetarëve ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare, duke filluar nga grupi më i vogël në numër.”.

(vi) **Neni 49** parashikon: “1. Për çështje të procedurës fjala jepet menjëherë. Janë çështje të procedurës kërkesat që kanë të bëjnë me zbatimin e Rregullores, kërkesat që përmbajnë propozime për ndryshime ose plotësime të rendit të ditës së miratuar, kërkesat për ndërprerjen ose shtyrjen e seancës plenare ose të diskutimeve, si dhe kërkesat që kanë të bëjnë me mënyrën e marrjes së vendimeve ose kryerjes së votimit. 2. Ndërhyrjet për çështjet e procedurës bëhen shkurtimisht dhe pa prekur thelbin e çështjes kryesore. 3. Në këto raste, përveç propozuesit që diskuton jo më shumë se 3 minuta, kanë të drejtë të diskutojnë një folës pro dhe një folës kundër jo më shumë se 2 minuta secili dhe merret vendim me votim të hapur nga Kuvendi me ngritjen e dorës.”.

(vii) **Neni 110** parashikon: “1. Data e seancës plenare për miratimin e programit politik dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave në zbatim të nenit 97 të Kushtetutës, përcaktohet nga Kryetari i Kuvendit në marrëveshje me Kryeministrin. 2. Programi politik i Këshillit të Ministrave dhe përbërja e tij paraqiten në Kuvend nga Kryeministri. 3. Pas paraqitjes së programit politik, çdo deputet dhe grup parlamentar ka të drejtë të paraqesë pyetje për Kryeministrin. 4. Pas përgjigjeve të pyetjeve së pyetjeve, Kryetari i Kuvendit deklaron hapjen e debatit për programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave. Koha e debatit përcaktohet nga Konferenca e Kryetarëve në përputhje me nenin 48 të kësaj Rregulloreje. Në përfundim të debatit, pas fjalës së kryetarëve të grupeve parlamentare, ka të drejtë të flasë Kryeministri jo më shumë se 10 minuta. Votimi nga Kuvendi i përbërjes dhe programit politik të Këshillit të Ministrave bëhet sipas

nenit 58 të kësaj Rregulloreje. 5. Në rast se Kuvendi nuk miraton programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave, Kryetari i Kuvendit vë në dijeni menjëherë Presidentin e Republikës. 6. Në rastin e parashikuar në nenin 96, pika 3, të Kushtetutës, Kryetari i Kuvendit fton kryetarin e partisë ose të koalicionit të partive që kanë shumicën e vendeve në Kuvend që brenda 3 ditëve të propozojë Kryeministrin e ri. Propozimi për zgjedhjen e Kryeministrit të ri shqyrtohet nga Kuvendi në seancë plenare jo më vonë se 7 ditë nga data e propozimit.”.

- (viii) **Neni 114** parashikon: “1. Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë i paraqitet Kryetarit të Kuvendit me shkrim dhe në mënyrë të motivuar e konkrete për shkaqet e parashikuara në Kushtetutë dhe jo nga më pak se 28 deputetë, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj. Me paraqitjen e kërkesës, Kryetari i Kuvendit vë menjëherë në dijeni Kuvendin dhe anëtarin e organit kushtetues për të cilin kërkohet shkarkimi. 2. Kryetari i Kuvendit ia përcjell kërkesën me dokumentet shoqëruese të saj Komisionit për Cështjet Ligjore dhe Administratën Publike, i cili brenda 15 ditëve i paraqet Kuvendit raportin dhe propozimin e tij për ngritjen ose mosngritjen e një komisioni hetimor. Në rast se personi për të cilin kërkohet shkarkimi dëshiron të shprehet në Komision, Komisioni është i detyruar ta dëgjojë atë, duke i lënë një kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe dhënien e sqarimeve. Kuvendi zhvillon debat në seancë plenare jo më vonë se 7 ditë nga data e paraqitjes së raportit të Komisionit për Cështjet Ligjore dhe Administratën Publike dhe në përputhje me kohën e përcaktuar nga Konferenca e Kryetarëve, sipas nenit 48 të kësaj Rregulloreje. Në rast se Kuvendi rrëzon nëpërmjet votimit raportin dhe propozimin e paraqitur nga ky Komision, procedura për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues ndërpritet. Kuvendi për të njëjtin motiv nuk mund të vendosë përsëri edhe nëse kërkesa paraqitet nga një grup tjetër deputetësh. Në rast se Kuvendi pranon nëpërmjet votimit raportin dhe propozimin e Komisionit, ngre brenda 2 ditëve një komision hetimor për këtë çështje. Komisioni hetimor është i detyruar të thërrasë dhe të dëgjojë mendimin e anëtarit të organit kushtetues për të cilin kërkohet shkarkimi në lidhje me propozimin e paraqitur. Në rast se kërkohet shkarkimi i anëtarit të organit kushtetues për paaftësi mendore

ose fizike, komisioni hetimor cakton jo më pak se 5 mjekë, specialistë në fushën përkatëse mjekësore, për t'u shprehur për gjendjen shëndetësore të personit. Në përfundim të hetimit, komisioni hetimor duhet t'i paraqesë Kuvendit në mënyrë të arsyetuar nëse ekzistojnë shkaqet për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues.

3. Kuvendi shqyrton raportin e komisionit hetimor në një seancë të vecantë brenda 20 ditëve nga paraqitja e tij. Konferenca e Kryetarëve përcakton datën e votimit në Kuvend të kërkesës për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues, si dhe kohën e debatit, sipas nenit 48 të kësaj Rregulloreje. Në rast se anëtari i organit kushtetues për të cilin është paraqitur kërkesa për shkarkim kërkon të dëgjohet në seancë plenare, Kuvendi është i detyruar ta dëgjojë atë. Kuvendi vendos për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues me shumicën e parashikuar rast pas rasti në Kushtetutë. Për ato raste që parashikohen në Kushtetutë, vendimi i Kuvendit për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues i dërgohet brenda 5 ditëve Gjykatës Kushtetuese.

4. Kërkesa për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit paraqitet sipas pikës 1 të këtij neni dhe shqyrtohet nga Këshilli për Legjislacionin, i cili paraqet raportin përkatës në seancë plenare. Në rast se kërkohet, Këshilli për Legjislacionin dhe Kuvendi në seancë plenare janë të detyruar të dëgjojnë Kryetarin e Kuvendit. Në këtë rast seanca plenare drejtohet nga Zëvendëskryetari që i përket shumicës parlamentare.”.

- (ix) **Neni 117** parashikon: “Cdo deputet ka të drejtë të paraqesë propozime për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit. Për shqyrtimin e këtyre propozimeve ndiqet procedura e parashikuar në këtë Rregullore për paraqitjen dhe shqyrtimin e projektligjeve. Ndryshimet në këtë Rregullore miratohen me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.”.

IV. ANALIZA LIGJORE

22. Kushtetuta e Shqipërisë ka parashikuar se Kuvendi zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e vet. Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve (shih nenin 75, pika 1, të Kushtetutës). Ndërsa, Rregullorja e Shqipërisë ka parashikuar se kërkesa për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit i paraqitet Këshillit të Legjislacionit, i cili paraqet raportin përkatës në seancë plenare. Kërkesa duhet të bëhet me shkrim dhe në mënyrë të motivuar për shkaqet e parashikuara në Kushtetutë, nga jo më pak se 28 deputetë (shih nenin 114, pika 4, të Rregullores).

23. Kryetari i Kuvendit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, në këtë periudhë të shkurtër të drejtimit të Kuvendit të Shqipërisë, ka dëshmuar mungesë të plotë të angazhimit për të ushtruar funksionin në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendi, si dhe duke u sjell si një vartës i Kryeministrit, i cili mori *defacto* edhe drejtimin e seancës së datës 18.09.2025, herë duke urdhëruar kush do fliste, herë duke urdhëruar kush deputet do të fliste për procedurë dhe herë duke urdhëruar Kryetarin e Kuvendit për procedurën që duhet të ndiqte.

24. **Shkelja nr. 1:** Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Z. Niko Peleshi ka thirrur mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 16 Shtator 2025, pa respektuar afatin e parashikuar nga neni 27/1, pika 3, e Rregullores së Kuvendit, përkatësisht si rregull 7 ditë përpara, por në cdo rast jo më vonë se 2 ditë përpara datës së caktuar për seancën plenare. Për rrjedhojë, kjo mbledhje, ashtu si edhe cdo vendimmarrje e saj është e pavlefshme, sipas parashikimit të nenit 78, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, e cila parashikon se mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas Rregullores së Kuvendit nuk sjellin asnjë pasojë.

25. **Shkelja nr. 2:** Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Z. Niko Peleshi ka thirrur mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, si dhe ka përfshirë për shqyrtim dhe miratim projektvendime për disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit, duke mos respektuar afatin e parashikuar nga neni 83, pika 2, e Kushtetutës dhe neni 28, pika 4, e Rregullores së Kuvendit. Rregullorja e Kuvendit parashikon se shqyrtimi nuk mund të fillojë pa kaluar një javë nga data e depozitimit të kërkesës, ndërsa Kushtetuta parashikon se shqyrtimi dhe miratimi nuk

të kryhen pa kaluar një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit. Shqyrtimi dhe miratimi i projektvendimit për disa ndryshime në Rregulloren e Kuvendit brenda të njëjtës ditë që është marrë vendimi për shqyrtimin me procedurë të përshpejtuar është në kundërshtim flagrant me nenin 83, pika 2, të Kushtetutës dhe nenin 28, pika 4, të Rregullores së Kuvendit.

26. **Shkelja nr. 3:** Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Z. Niko Peleshi iu ka hequr të drejtën deputetëve të Kuvendit për të diskutuar mbi përmbajtjen e projektvendimit, në kundërshtim me nenet 73, pika 1 dhe 76, pika 1, të Kushtetutës së Shqipërisë, si dhe nenet 46, pika 1, dhe 48, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, të cilat sanksionojnë të drejtën e deputetëve për të diskutuar rreth çështjes për një kohë të paktën 10 minuta për çdo projektligj, projektvendim apo çështje të përfshirë në rendin e ditës, me përjashtim të rasteve kur Rregullorja parashikon ndryshe. Megjithëse, në Rregullore nuk ka asnjë parashikim që i heq të drejtën deputetit për të diskutuar lidhur me projektvendimin për ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, Kryetari i Kuvendit iu ka mohuar të drejtën e fjalës deputetëve të opozitës që kishin kërkuar të diskutonin për përmbajtjen e projektvendimit.

27. **Shkelja nr. 4:** Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Z. Niko Peleshi, në mënyrë të përsëritur, i ka mohuar Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, të drejtën e fjalës për procedurë në kundërshtim me nenin 49, pika 1, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, i cili sanksionon se për çështje të procedurës fjala jepet menjëherë. Ndërkohë që dy herë rresht i ka dhënë fjalën Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, duke shfaqur një qëndrim tërësisht të njëanshëm dhe partiak, në kundërshtim me nenin 7, pika 2, të Rregullores së Kuvendit që parashikon se Kryetari i Kuvendit drejton dhe moderon në mënyrë të paanshme debatet. Po ashtu, në kundërshtim me nenin 49, pika 3, të Rregullores, Kryetari i Kuvendit nuk i ka dhënë fjalën një folësi kundër të opozitës për propozimet e bëra nga Kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së.

28. **Shkelja nr. 5:** Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Z. Niko Peleshi, në kundërshtim flagrant me nenin 97, të Kushtetutës së Shqipërisë dhe nenin 110 të Rregullores së Kuvendit, nuk ka mundësuar paraqitjen e programit politik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave nga

Kryeministri përpara procesit të votimit; i ka mohuar të drejtën e deputetëve të Kuvendit për të bërë pyetje lidhur me programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave; i ka mohuar të drejtën e fjalës dhe debatit parlamentar deputetëve lidhur me programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave; i ka mohuar të drejtën e fjalës kryetarëve të grupeve parlamentare në përfundim të debatit parlamentar; si dhe i ka mohuar të drejtën për të votuar deputetëve të Kuvendit pas përfundimit të debatit parlamentar. Praktikisht, për shkak të sjelljes tërësisht të njëanshme, në kundërshtim flagrant me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, Kryetari i Kuvendit Z. Niko Peleshi ka pamundësuar zhvillimin e rregullt të seancës plenare më të rëndësishme në fillim të legjislaturës së re.

29. Në këto kushte, për shkak të sjelljeve të përsëritura, veprimeve dhe mosveprimeve në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit, Kryetari i Kuvendit Z. Niko Peleshi është në kushtet e parashikuara nga neni 75, pika 1, e Kushtetutës dhe neni 114, pika 1 dhe 4, të Rregullores së Kuvendit, për shkarkimin nga kjo detyrë. Kushtetuta e Shqipërisë, ashtu si edhe Rregullorja e Kuvendit në frymë dhe në gërmë, kanë sanksionuar statusin dhe figurën e Kryetarit të Kuvendit, si person që qëndron mbi palët dhe shërben për zgjidhjen dhe ndërmjetësimin e problemeve që mund të krijohen gjatë aktivitetit parlamentar, megjithëse fillimisht propozohet dhe zgjidhet nga një palë politike e caktuar. Nga faktet, e drejta e aplikueshme dhe analiza ligjore është e qartë se Z. Niko Peleshi nuk përmbush këtë status të vecantë, pasi me sjelljet, veprimet dhe mosverpimet e tij kanë treguar sjellje krejtësisht të njëanshme, që nxit tensionin dhe konfliktin ndërmjet palëve, duke pamundësuar zhvillimin normal të debatit parlamentar.

V. KONKLUZIONE

30. Prandaj duke pasur parasysh sa më sipër, në kushtet kur në seancat plenare të datave 16.09.2025 dhe 18.09.2025, Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Niko Peleshi ka kryer shkeljet e mëposhtme:

- Thirrja e mbledhjes së Kuvendit, në seancat e datës 16 Shtator 2025, në kundërshtim me pikën 3, të nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, duke sjell pasojën e parashikuar nga pika 2, e nenit 78 të Kushtetutës – mbledhjet e deputetëve që mbahen pa u thirrur sipas Rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë;
- Thirrja e mbledhjes së Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në kundërshtim me nenin 83, pika 3 të Kushtetutës, pikën 4 të nenit 28 dhe nenin 117 të Rregullores së Kuvendit;
- Përfshirja për votim dhe miratimi i akteve në Kuvend, në kundërshtim me procedurën kushtetuese të miratimit, duke shkelur nenin 83, pika 3 të Kushtetutës së Shqipërisë, pikën 4 të nenit 28 dhe nenin 117 të Rregullores së Kuvendit;
- Heqja e të drejtës së deputetëve të opozitës për të diskutuar mbi përmbajen e projektaktit, në kundërshtim me nenin 73 e vijues dhe nenin 117 të Rregullores së Kuvendit;
- Në kundërshtim me nenin 49 të Rregullores së Kuvendit, i ka mohur Kryetarit të Grupit Parlamentar të PD, dy herë të drejtën e fjalës për procedurë, e cila sipas Rregullores jepet menjëherë sapo kërkohet. Ndërkohë që këtë të drejtë ia ka njohur Kryetarit të Grupit Parlamentar të PS dy herë rresht, duke shfaqur njëanshmëri të theksuar në drejtimin e seancës;
- Në kundërshtim me nenin 97 të Kushtetutës dhe nenit 110 të Rregullores së Kuvendit, nuk ka mundur paraqitjen e programit politik dhe përbërjes së Këshillit të Ministrave nga Kryeministri përpara procesit të votimit;
- Në kundërshtim me nenin 97 të Kushtetutës dhe nenit 110 të Rregullores së Kuvendit, i ka mohur të drejtën deputetëve për të bërë pyetje përpara procesit të votimit;

- Në kundërshtim me nenin 97 të Kushtetutës dhe nenit 110 të Rregullores së Kuvendit, nuk ka lejuar debat parlamentar, ku çdo deputet mund të diskutojë për 10 minuta, përpara procesit të votimit;
- Në kundërshtim me nenin 97 të Kushtetutës dhe nenit 110 të Rregullores së Kuvendit, ka mohuar të drejtën e kryetarëve të grupeve parlamentare për të diskutuar në përfundim të debatit parlamentar;
- Në kundërshtim me nenin 97 të Kushtetutës dhe nenit 110 të Rregullores së Kuvendit, ka mohuar të drejtën e deputetëve për të votuar vetëm pasi kanë ushtruar të drejtën për debat;
- Me ndërgjegje ka lejuar që votim në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren, duke e bërë atë të pavlefshëm; vlerësojmë se përmbushen plotësisht kushtet e parashikuara nga neni 75, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 114, pikat 1 dhe 4, të Rregullores së Kuvendit, për shkarkimin e tij nga detyra e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

R E L A T O R I

Ivi KASO